



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), dhe nenet 85 dhe 114 të Ligjit Nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.11/11 maj 2012), si dhe në zbatim të nenit 2, paragrafi 2, nënparagrafi 2.3, dhe nenit 12, paragrafi 2, të Ligjit Nr.05/L-110 për Kamatë - Vonesa në Transaksionet Tregtare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 38/21 nëntor 2016), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 29 gusht 2019, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR KAMATËVONESËN E INSTRUMENTEVE KREDITORE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë procedurën që do të ndiqet nga institucionet financiare kredidhënëse për të ngarkuar kamatëvonesën, si dhe të përcaktojë metodën për caktimin dhe llogaritjen e shumës së kamatëvonesës së ngarkuar ndaj instrumenteve kreditore të cilat janë në vonesë.
2. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha institucionet financiare kredidhënëse të licencuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (në vijim: BQK) të cilat operojnë në Kosovë.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjithë termat e përdorur në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me termat e përkufizuara në nenin 3 të Ligjit Nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (në vijim: Ligji për Bankat), në Rregulloren për Menaxhimin e Rrezikut Kreditor, Rregulloren për Adekuatshmërinë e Kapitalit të Bankave, Rregulloren për Normën Efektive të Interesit dhe Kërkesat për Shpalesje, dhe Ligjit Nr.05/L-110 për Kamatë-Vonesa në Transaksionet Tregtare, si dhe/ose me përkufizimet në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:
 - 1.1. **Institucion financiar kredidhënës** - nënkupton institucionet financiare të licencuara apo regjistruara nga BQK-ja për të ushtruar veprimtari të kredidhënies.
 - 1.2. **Instrument kreditor** - nënkupton çdo hua ose zotim ligjor direkt apo indirekt për dhënien e një shume parash me të drejtën e kthimit të asaj shume të dhënë dhe të

papaguar dhe të pagesës së interesit ose ndonjë detyrimi tjetër në atë shumë. Instrumenti kreditor për qëllimin e kësaj rregulloreje përfshin kreditë, kartat e kreditit, mbitërheqjet dhe instrumentet tjera kreditore.

- 1.3. **Norma referente** - paraqet pikën në mes të normës efektive të interesit në kredi të reja që marrin bankat dhe normës efektive të interesit në depozita të reja që paguajnë bankat. Llogaritja e normës referente bëhet duke marrë për bazë mesataren në gjashtë muajt e fundit (janar-qershor ose korrik-dhjetor) të normës së interesit për kontratat e reja në kredi dhe depozita, e llogaritur dhe publikuar nga BQK.
- 1.4. **Kreditori** - nënkupton institucionin financiar kredidhënës që i huazon para debitorit dhe është përfitues i pagesave të debitorit të arritura për pagesë sipas kushteve dhe afateve të marrëveshjes së kredisë. Kreditori njihet gjithashtu edhe si huadhënës.
- 1.5. **Debitori** – nënkupton personin fizik ose juridik i cili merr para hua nga një institucion financiar kredidhënës sipas kushteve dhe afateve të marrëveshjes së kredisë apo ai i cili i ka borxh një institucionin financiar kredidhënës sipas një instrumenti kreditor. Debitori njihet gjithashtu edhe si kredimarrësi.
- 1.6. **Pagesa në Vonesë** – nëse debitori dështon të kryejë pagesën me rregull, siç është caktuar me kushtet dhe afatet e marrëveshjes përkatëse të instrumentit kreditor, ndaj institucionit financiar kredidhënës, pagesa është në vonesë dhe debitori do të konsiderohet në vonesë.

Neni 3

Llogaritja e ditëve të vonesës

1. Institucioni financiar kredidhënës mund t'i lejojë debitorit një periudhë tolerimi nga data e caktuar e pagesës sipas afateve të marrëveshjes, gjatë së cilës pagesa nuk konsiderohet e vonuar për qëllim të aplikimit të kamatëvonesës.
 - 1.1. Periudha e tolerimit duhet të përcaktohet në marrëveshjen e instrumentit kreditor;
 - 1.2. Periudha e tolerimit nuk mund të jetë më e gjatë se 21 ditë kalendarike;
 - 1.3. Në qoftë se pagesa e instrumentit kreditor nuk realizohet brenda periudhës së tolerimit, pagesa e instrumentit kreditor do të konsiderohet në vonesë dhe institucioni financiar kredidhënës do të ngarkojë kamatëvonesën. Në këtë rast kamatëvonesa mund të aplikohet duke filluar nga data e fillimit të periudhës së tolerimit.
2. Numri i ditëve në vonesë për çdo pagesë të vonuar do të llogaritet nga institucioni financiar kredidhënës.
3. Data e fillimit të vonesës së pagesës për muajin aktual duhet të jetë:
 - 3.1. Data pasuese e datës së caktuar për pagesë bazuar në kushtet dhe afatet e marrëveshjes së instrumentit kreditor, ose
 - 3.2. Data pasuese e datës së përfundimit të periudhës së tolerimit.

4. Numri i ditëve në vonesë do të llogaritet për të gjitha ditët kalendarike në periudhën kontabël, e cila nënkupton periudhën nga data e parë e vonesës deri tek data paraprake e datës efektive të pagesës së kryegjësë në vonesë.

Neni 4

Përlllogaritja e normës së kamatëvonesës

1. Nëse debitori vonon në përmbushjen e detyrimit sipas instrumentit kreditor, ai do të paguajë kamatëvonesën në shumën e kryegjësë së vonuar sipas normës së përcaktuar në këtë rregullore.
2. Llogaritja e normës së kamatëvonesës do të jetë norma vjetore (Nv), e cila përbëhet nga norma referente e rritur për 8 pikë përqindje normë fikse. Normën referente do ta publikojë BQK çdo gjashtë muaj. Me datë 1 shkurt publikohet norma që merr për bazë mesataren për periudhën korrik-dhjetor dhe vlen për periudhën e ardhshme nga data 10 shkurt deri më 9 gusht; kurse më datë 1 gusht të vitit kalendarik publikohet norma që merr për bazë mesataren për periudhën janar-qershor dhe vlen për periudhën e ardhshme nga data 10 gusht deri më 9 shkurt.
3. Në rast se BQK nuk ka publikuar normën e re referente, duhet të përdoret norma referente e BQK-së e publikuar së fundi.
4. Norma aktuale e kamatëvonesës mund përcaktohet nga institucioni financiar kredidhënës në çdo përqindje më të vogël sikurse është përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni.

Neni 5

Metoda e përlllogaritjes së kamatëvonesës

1. Kamatëvonesa do të përlllogaritet për shumën e kryegjësë në vonesë përgjatë numrit të ditëve kalendarike në vonesë varësisht nga numri i ditëve kalendarike të vitit (365 ose 366), duke aplikuar formulën matematikore si më poshtë:

$$KV = \frac{B * Nv * D}{Nd}$$

ku:

KV – kamatëvonesa për periudhën kontabël;

B –Borxhi kryesor (kryegjësja) në vonesë;

Nv – Norma vjetore e kamatëvonesës;

D – Numri i ditëve kalendarike të kamatëvonesës gjatë periudhës kontabël;

Nd – Numri i ditëve kalendarike të vitit (365 ditë – viti i zakonshëm, 366 ditë – viti i brishtë).

2. Kamatëvonesa e llogaritur për secilën periudhë kontabël (zakonisht mujore) i shtohet kamatëvonesës së përlllogaritur, kështu që, kamatëvonesa e përlllogaritur është shuma totale

e të gjitha kamatëvonesave të llogaritura për të gjitha pagesat në vonesë të kryegjësë deri me ditën e llogaritjes.

Neni 6 **Shpalosja**

Marrëveshjet e të gjitha instrumenteve kreditore duhet të përmbajnë dispozitat që përshkruajnë në mënyrë të qartë dhe të plotë pasojat në rast të pagesave në vonesë, përfshirë mënyrën e ngarkesës së kamatëvonesës, si dhe të sigurohen se debitori i kupton të gjitha këto pasoja të mundshme.

Neni 7 **Dispozitat përfundimtare**

1. Kjo rregullore aplikohet për të gjitha instrumentet kreditore të aprovuara nga institucionet financiare kredidhënëse pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.
2. Përfundimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, për instrumentet kreditore të aprovuara para se kjo rregullore të hyjë në fuqi, për rastet e vonesave që ndodhin pas hyrjes në fuqi të rregullores, institucionet financiare kredidhënëse nuk mund të aplikojnë normë më të lartë të kamatëvonesës se sa niveli i përcaktuar i kamatëvonesës me anë të kësaj rregulloreje.
3. Nëse norma e kamatëvonesës e përcaktuar në marrëveshjet e instrumenteve kreditore të aprovuara para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje është më e favorshme për klientin se sa norma e përcaktuar me këtë rregullore, institucionet financiare kredidhënëse në rast të aplikimit të kamatëvonesës duhet të aplikojnë normën e kamatëvonesës të përcaktuar në ato marrëveshje të instrumenteve kreditore edhe në vonesat e ndodhura pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 8 **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe ndëshkuese siç përcaktohet në Ligjin Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Bankat.

Neni 9 **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Flamur Mrasori

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës